



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 1449 Prot

Vlorë, më 24.09.2024

VENDIM

Nr. 17 datë 23 / 09 / 2024

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË
QARKUT TË VITIT 2024, MIRATUAR ME VKQ Nr.16 Dt. 27.12.2023, I
NDRYSHUAR**

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për përgatitjen e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë të vitit 2024, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore". i ndryshuar, neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dhe, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40.
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 97/2023 datë 7.12.2023 "Për Buxhetin e vitit 2024".
- V.K.M. nr. 503 dt. 01.08.2024 "Për disa ndryshime nr Vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore."
- V.K.M. nr. 421 dt. 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar."
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 dt.24.01.2024 datë "Për zbatimin e buxhetit" të vitit 2024.

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën në buxhetin e vitit 2024, fondin e akorduar nga Ministria e Financave për rritjen e pagave për vitin 2024, në vlerën 2,047,500 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

a- Ky fond do të shpërndahet në buxhetin e vitit 2024 sipas strukturave buxhetore të mëposhtme:

-llogaria 600	1,000,000 lekë
-llogaria 601	1,047,500 lekë

2. Të miratojë shtesën në buxhetin e vitit 2024 fondin e akorduar nga Ministria e Brendshme për rritjen e pagave të Drejtorisë së Administrimit të Tokës për vitin 2024 në vlerën 410,000 lekë.

a-Ky fond do të shpërndahet në buxhetin e vitit 2024 sipas strukturave buxhetore të mëposhtme:

-llogaria 600	300,000 lekë
-llogaria 601	110,000 lekë

3. Të miratojë detajimet në zërin “Investime në Bashkitë e Qarkut” (llogaria 230-231) si më poshtë:

3.1. Pakësime në llogarinë ekonomike 231

- Të pakësohet vlera prej 30,750,000 lekë nga totali prej 41,000,000 lekë për investimin “Ndërtim pedonale pranë Urës së Bratit” (kod projekti: 0370064). Për vitin 2024 të planifikohen 10,250,000 lekë, ndërsa 30,750,000 lekë të parashikohen në buxhetin e vitit 2025.

3.2. Shtesa në llogarinë ekonomike 231

- Të shtohet investimi “Rikonstruksion i disa akseve të rrugëve të fshatit Aliban, Njësia Administrative Novoselë” me një vlerë totale prej 39,000,000 lekë, nga të cilat 30,750,000 lekë do të mbulohen nga buxheti i vitit 2024 dhe 8,250,000 lekë të parashikohen në buxhetin e vitit 2025.

Ndryshimet e detajuara në zërat 600, 601 dhe 231 janë pasqyruar në relacionin bashkëlidhur.

4. Ndryshimet e nevojshme të pasqyrohen në dokumentin përfundimtar të PBA 2025-2027.

5. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut brenda Institucionit.

6. Përgjegjësi i Financës - Buxhetit pranë Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuar nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për cdo muaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. 877/ Prot, datë 25.09.2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PALLATI I KULTURËS LABËRIA

Relacion për ndryshime në Buxhetin e vitit 2024 , miratuar me VKQ nr.16
dt.27.12.2023, i ndryshuar.

Grupi i punës mbështetur në

- Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41 ,neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83 pika ç.
- Ligjin nr. 84/2023 “ për Buxhetin e vitit 2024“.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”i ndryshuar.
- Ligjin nr. 97/2023 datë 7.12.2023 “ Për Buxhetin e vitit 2024”.

Në bazë të shkresës nr. 11788, datë 04.09.2024, të Ministrisë së Financave, është shtuar fondi për rritjen e pagave në vlerën prej 2,047,500 lekë në llogarinë 604. Ky fond do të shpërndahet si më poshtë:

- *Shtim në Kap. I në vlerën 2,047,500 lekë*

-llogaria 600	1,000,000 lekë
-llogaria 601	1,047,000 lekë

Në bazë të shkresës nr. 8117/3, datë 25.08.2024, të Ministrisë së Brendshme, është shtuar fondi për rritjen e pagave për Drejtorinë e Administrimit të Tokës në vlerën prej 410,000 lekë, i cili do të alokohet në llogaritë 600 dhe 601. Ky fond do të shpërndahet si më poshtë:

-llogaria 600	300,000 lekë
-llogaria 601	110,000 lekë

- *Pakësim në zërin 231 kapitull 1, me kod projekti 370064 “Ndërtimi i pedonales pranë Urës së Bratit”, në vlerën 20,000,000 lekë.*
- *Pakësim në zërin 231 kapitull 5, me kod projekti 370064 “Ndërtimi i pedonales pranë Urës së Bratit”, në vlerën 10,750,000 lekë.*
- *Shtohet në zërin 231 kapitull 1, me kod projekti 370064 “Ndërtimi i pedonales pranë Urës së Bratit”, në vlerën 10,000,000 lekë.*
- *Shtohet në zërin 231 kapitull 5, me kod projekti 370064 “Ndërtimi i pedonales pranë Urës së Bratit”, në vlerën 250,000 lekë.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PALLATI I KULTURËS LABËRIA

- Shtohet investimi "Rikonstruksion i disa akseve të rrugëve të fshatit Aliban, Njësia Administrative Novoselë" në vlerën 20,000,000 lekë llogaria ekonomike 231 kapitull 1, (vlerë e ardhur nga ndryshimi në llogarinë 231).
- Shtohet investimi "Rikonstruksion i disa akseve të rrugëve të fshatit Aliban, Njësia Administrative Novoselë" në vlerën 10,750,000 lekë llogaria ekonomike 231 kapitull 5, (vlerë e ardhur nga ndryshimi në llogarinë 231).

Çdo ndryshim në llogaritë e mësipërme është i detajuar me relacionet nga çdo sektor, kërkesë, preventiv dhe projekt nga çdo Bashki.

Grupi i punës:

Sekretar i Përgjithshëm
Z.Klaud Gjipali

Përgjegjese sektorit Financës
Znj.Anisa Hyseni

Specialist Finance për zbatimin e Buxhetit
Z. Mauricio Pashaj

Specialist i Shërbimeve
Z.Muhedin Bego

Sepcialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Territorit
Znj.Blerina Lula

Specialist Jurist

Znj.Alma Myrtaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION PËR BUXHET

Në kuadër të ndryshimeve të propozuara në buxhetin e vitit 2024 dhe përgatitjes së dokumentacionit final të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027, si dhe duke marrë parasysh kërkesat e paraqitura nga Bashkitë përkatëse dhe afatet kohore të realizimit të këtyre projekteve, propozohet sa vijon:

1. **Projekti “Ndërtim i pedonales pranë Urës së Bratit” – Bashkia Selenicë**

Në buxhetin e miratuar të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024, sipas VKQ Nr. 16, datë 27.12.2023, është parashikuar financimi për projektin "Ndërtimi i pedonales pranë Urës së Bratit", në fshatin Brataj, Bashkia Selenicë. Për realizimin e këtij investimi, Këshilli i Qarkut Vlorë i ka kërkuar Bashkisë Selenicë paraqitjen e një dosjeje të plotë, e cila përfshin: projektin e zbatimit, opionencën teknike, vlerësimin e ndikimit në mjedis, lejen e ndërtimit, dhe dokumente të tjera teknike të nevojshme. Këto dokumente sigurojnë që projektet të kryhen në përputhje me procedurat ligjore dhe teknike gjatë fazave të prokurimit dhe zbatimit. Deri më tani, një pjesë e këtij dokumentacioni është dorëzuar, por ende mbeten disa dokumente për të plotësuar dosjen në tërësi, për të siguruar vijimin e mëtejshëm të procedurave.

2. **Projekti “Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Aliban” – Bashkia Vlorë**

Bashkia Vlorë ka paraqitur pranë Këshillit të Qarkut Vlorë një kërkesë për financimin e projektit “Rikonstruksion i disa akseve rrugore në fshatin Aliban, Njësia Administrative Novoselë”. Ky investim është parashikuar fillimisht në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025. Në përputhje me ndryshimet e që do të pasqyrohen në dokumentin përfundimtar të PBA 2025-2027, është planifikuar që projekti të fillojë në vitin 2024, me synim përfundimin e tij gjatë vitit 2025.

Duke marrë parasysh afatet kohore dhe kohën e kufizuar në dispozicion për përmbushjen e dokumentacionit të plotë të këtyre investimeve, është menduar që të parashikohet një fond fillestar për vitin 2024, me qëllim nisjen e procedurave të prokurimit, me kusht që dokumentacioni i kërkuar të përfundojë brenda afateve ligjore. Kjo do të mundësojë fillimin dhe realizimin e suksesshëm të këtyre projekteve pa pengesa të mëvonshme në fazën e zbatimit.

Punoi : Spec. Urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit

Ing. Blerina Luja

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 603